



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE**  
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE PROTOKOLL - ARKIVËS**

Nr.....Prot.

Vlorë më, 22.10.2018

**Lënda: Njoftim punësimi**

**Drejtuar: Z. Altin Mahilaj**  
Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Teknologjike dhe Zhvillimit

Bazuar në Urdhërin Nr.85, datë 19.10.2018 të Rektorit, ju lutem të shpallni njoftimin zyrtar për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në web-in e Universitetit, sipas njoftimit bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**DREJTOR**

**Eloina Tozaj**

**Konceptoi:**  
**E.Breshanaj**  
**Përgjegjës sektori**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE**  
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE PROTOKOLL - ARKIVËS**

**NJOFTIM**

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, bazuar në Urdhërin Nr.85, datë 19.10.2018 të Rektorit, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë:

**1. Për personel ndihmësakademik Laborant 1 (një) në Departamentin e Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike**

Kandidati i interesuar duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme të mëposhtme (neni 41 i Statutit dhe neni 28 i Rregullores):

- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe studentët;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një krimi;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore e largimit nga puna apo zgjidhjes së kontratës nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë;
- Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të universitetit dhe autoriteteve drejtuese, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

**Kriteret e seleksionimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve**

- Të ketë përfunduar Studimet e Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë Master i Shkencave në një nga fushat si më poshtë: Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Elektronikë ose në fusha të ngjashme.
- Të ketë eksperiencë pune minimalisht 2-vite në pozicionet e IT.
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, të jetë i motivuar për të punuar në grup.
- Të jetë i aftë të garantojë standard cilësie dhe efikasitet në punë.
- Të mos ketë vepruar apo propaganduar për cënimin e imazhit të Universitetit dhe të plotësojë kërkesat për punësim sipas Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
- Të mos ketë konflikte interesi në njësinë përkatëse ku do të punësohet.
- Të mos jetë marrë më parë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna.
- Të zotërojë aftësi të mira menaxhuese dhe integritet në vendin e punës. Një precedent i mëparshëm negativ në eksperiencën e punës së kandidatit do të sillte skualifikimin e tij për në fazat e tjera të intervistimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE**  
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE PROTOKOLL - ARKIVËS**

**DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

- a) Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:
- Formularin e aplikimit të shkarkueshëm nga faqja zyrtare e Universitetit [www.univlor.edu.al](http://www.univlor.edu.al) .
  - Kopje e letërnjoftimit;
  - Kërkesë me shkrim
  - Kopje e jetëshkrimit (CV);
  - Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave të studimeve universitare
  - Lista e notave të studimeve universitare duhet të jetë origjinale
  - Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent.
  - Dëshmi apo diploma të studimeve, të trajnimeve dhe kualifikimeve të tjera, të jete te noterizuara.
  - Kopje e noterizuar e librezës së punës
  - Kopje e noterizuar e certifikatave ose diplomave të kualifikimeve apo specializimeve;
  - Vërtetim i gjendjes gjyqësore/vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
  - Vërtetim i gjendjes shëndetësore ,origjinal, i tre muajve te fundit
  - Kopje e noterizuar e dëshmimeve të njohjes së gjuhës së huaj
  - Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm që provojnë vlerësimet pozitive në punë.
  - Deklaratë personale që nuk figuron në proces gjyqësor me UV-në.
  - Deklaratë e kandidatit për mos pasjen e konfliktit të interesit dhe nepotizëm me personelin e Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë.

**Nuk lejohet dorëzimi i dokumentacionit dorazi.**

Kandidati që paraqet mangësi në dokumentacionin e dorëzuar nuk do të merret në konsideratë nga Komisioni *ad hoc*.

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:



**Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë,  
Lagjja. "Pavarësia", Rr. "Kosova"  
9400 Vlorë, Shqipëri  
Drejtorja e Komunikimit dhe e  
Burimeve Njerëzore  
Pozicioni përse aplikohet**

Kandidati i cili kalon fazën e parë të vlerësimit të dosjes por që nuk paraqitet në fazën e dytë, të intervistës me gojë, skualifikohet nga konkurimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE**  
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE PROTOKOLL - ARKIVËS**

Afati që u lihet kandidatëve për të aplikuar është 2 javë kalendarike nga dita e publikimit të njoftimit në faqen zyrtare të internetit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

**Afati i fundit i dorezimit të zarfave është data 05.11.2018.**

**ZARFAT E ARDHUR PAS KËTIJ AFATI NUK DO T'I KALOHEIN KOMISIONIT PËR VLERËSIM.**